



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 3589 Prot

*Të ndalo për cdo ditë
në bashkëpunim me Kuvendin
që të propozim mbledhjet*

21.11.18

Tiranë, më 13/11/2018

Lënda: Propozim për emërimin e një anëtari të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

Zotit Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar Zoti Kryetar,

Siç jeni në dijeni, Kuvendi i Shqipërisë bazuar në nenin 11, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, që prej datës 17.09.2018 ka ripublikuar në faqen zyrtare njoftimin për vendin vakant të njërit prej anëtarëve të bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) mandati i të cilit ka përfunduar më 25.04.2018.

Sa më sipër, pas përfundimit të afatit të paraqitjes së kandidaturave, në vijim të procedurave për emërimin e një anëtari të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë:

Ekipi Përzgjedhës, bazuar në nenin 11, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i propozon Kuvendit të Shqipërisë për pozicionin e anëtarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë kandidaturat e mëposhtme:

- 1. Z.Enton Shahaj;**
- 2. Znj.Raimonda Islamaj;**

Kandidaturat e propozuara plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 11 pika 5,ç të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe kanë njohuritë, eksperiencën dhe formimin e nevojshëm për të realizuar detyrën.

Bashkëlidhur CV-të e kandidaturave.

EKIPI PERZGJEDHES

Damian Gjiknuri

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë



Eduard Shalsi

Kryetar i Komisionit për Veprimtaritë
Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Erion Braçe

Kryetar i Komisionit për
Ekonominë dhe Financat

PROCES – VERBAL

I mbajtur në mbledhjen e Ekipit Përzgjedhës, më datë 13.11.2018 Për propozimin e kandidaturave për anëtar të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë

Ekipi Përzgjedhës në cilësinë e propozuesit të anëtarëve të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, bazuar në nenin 11, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i propozon Kuvendit të Shqipërisë, dy kandidatura për pozicionin e anëtarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, si më poshtë:

3. Z.Enton Shahaj;

4. Znj.Raimonda Islamaj;

Kandidaturat e propozuara plotësojnë kriteret ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 5,ç të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, për vendin e anëtarit të ERE-së.

I propozojmë këto kandidatura për të vijuar procedurat parlamentare, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Damian Gjiku

Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Eduard Shalsi

Kryetar i Komisionit për Veprimtaritë
Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Erion Braçe

Kryetar i Komisionit për
Ekonominë dhe Financat